

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË



REZYME E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS

“NDIKIMI I TERRORIZMIT NË QASJET MBI SIGURINË
NDËRKOMBËTARE PAS LUFTËS SË FTOHTË - RAST STUDIMI NATO-ja”

MENTOR I PARË: PROF. DR. IBRAHIM GASHI

MENTORI I DYTË: PROF.DR. AFRIM HOTI

KANDIDATI: FIDAN HALITI

PRISHTINË, 2023

Teza e disertacionit të doktoratës me titullin “*Ndikimi i terrorizmit në qasjet mbi sigurinë ndërkombëtare pas Luftës së Ftohtë - rast studimi NATO-ja*”, trajton një prej fenomeneve më komplekse dhe më sfiduese për sigurinë ndërkombëtare në një periudhë me shumë specifika, siç është periudha pas Luftës së Ftohtë. Në këtë periudhë që përfshin ky studim, ndodhin një sërë ngjarjesh që ndikuan në transformimin politik e shoqëror në nivel global, e një prej ngjarjeve që ndikoi në këtë transformim është padyshim globalizmi. Ky zhvillim ndikoi, përveç tjerash, që çështjet e sigurisë të marrin dimensione më të gjera, si në kuptimin akademik, ashtu edhe në atë praktik. Kërcënimet ndaj sigurisë në këtë periudhë u bënë më heterogjene dhe të njëjtat nuk mund të përballeshin me qasje dhe koncepte tradicionale të sigurisë, prandaj ndërveprimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm ishte i imponuar për të garantuar sukses. Edhe terrorizmi si aktor joshitetëror, në këtë periudhë bëhet më kompleks, si për nga format e organizimit, ashtu edhe për nga format e veprimit, duke paraqitur kërcënim për sigurinë ndërkombëtare si asnjëherë më parë. Prandaj, punimi trajton ndikimin që ka terrorizmi në qasjet mbi sigurinë ndërkombëtare, raportin mes aktorëve shtetërorë dhe atyre joshitetërorë në periudhën pas Luftës së Ftohtë, me vështrim të posaçëm mbi terrorizmin dhe reagimin e aktorëve shtetërorë ndaj këtij kërcënimi, duke marrë për studim të veçantë një aktor ushtarako-politik, siç është NATO-ja. Përveç kësaj, në punim analizohen dhe vlerësohen teoritë e sigurisë ndërkombëtare, ndikimi i terrorizmit në këto teori dhe qasjet për sigurinë ndërkombëtare. Për ta realizuar këtë, analizohet fenomeni i terrorizmit si kërcënim asimetrik dhe reagimi i aktorëve të ndryshëm shtetërorë dhe multilateralë në raport me këtë kërcënim.

Në aspektin strukturor, teza e doktoratës është e ndarë në 7 kapituj dhe në disa nënkapituj, të cilëve u paraprijnë: parathënia, hyrja dhe metodologjia e punimit, ku shpjegohen qëllimet dhe metodat, pyetjet hulumtuese dhe hipotezat të cilat janë përdorur.

Në kapitullin e parë trajtohen aspektet përkufizuese dhe konceptuale për sigurinë nga këndvështrimi i dy qasjeve teorike dominante në marrëdhëniet ndërkombëtare: teorinë e realizmit dhe atë të liberalizmit. Në këtë kapitull janë paraqitur përkufizime, koncepte dhe qasje për sigurinë nga studiues të ndryshëm, që e kanë trajtuar këtë temë nga këndvështrime të ndryshme akademike dhe në rrethana të ndryshme kohore. Të arriturat dhe informacionet që

paraqiten në këtë kapitull ofrojnë bazë të mirë të rritjes së kuptueshmërisë së aspekteve që trajton kjo temë hulumtimi.

Në kapitullin e dytë trajtohen sistemet e ndryshme të sigurisë ndërkombëtare në periudha të ndryshme historike, duke filluar me atë që njihet si sistemi i parë ndërkombëtar, Sistemi Vestfalian dhe ai i Koncertit të Vjenës, që kishin në epiqendër modelin e balancimit të fuqisë dhe të aleancave, sistemin e sigurisë kolektive në periudhën mes dy luftërave botërore, strategjinë frenim dhe përmbajtje të përdorur gjatë Luftës së Ftohtë dhe sistemin e sigurisë ndërkombëtare pas Luftës së Ftohtë. Në këtë kapitull paraqiten të arriturat kyçe të hulumtimit, duke argumentuar qasjet mbi sigurinë në periudha të ndryshme dhe ajo që është esenciale, ndryshimin e qasjeve mbi sigurinë në periudhën pas Luftës së Ftohtë, si pasojë e kërcënimeve nga terrorizmi.

Në kapitullin e tretë trajtohet çështja e terrorizmit nga një këndvështrim historik, aspektet përkufizuese dhe llojet e ndryshme të terrorizmit. Këtu pasqyrohet zanafilla e aktiviteteve terroriste, llojet dhe format e terrorizmit, çështjet e definicioneve dhe përkufizimeve, si dhe debatet e studiuesve përkitazi me terrorizmin.

Në kapitullin e katërt trajtohet veprimtaria e terrorizmit në periudhën bashkëkohore, ndikimet që patën sulmet e 11 shtatorit 2001 në Kullat Binjake në SHBA, në qasjet ndërkombëtare të luftës anti-terror. Me vështrim të posaçëm trajtohet veprimtaria e dy organizatave terroriste islamike, Al-Qaeda dhe ISIS. Në këtë kapitull nxirren rezultate të rëndësishme mbi ndikimin ndërkombëtar të këtyre organizatave terroriste.

Në kapitullin e pestë trajtohet qasja e organizatave ndërkombëtare në raport me kërcënimet në fushën e sigurisë nga terrorizmi në periudhën pas Luftës së Ftohtë, me vështrim në aktivitetet, politikat dhe strategjitë kundër terrorizmit të dy organizatave, siç janë OKB-ja dhe BE-ja. Vështrimi në këto dy organizata lidhur me qasjet e tyre në luftën kundër terrorizmit na ofron një pasqyrim domethënës për ndryshimin e qasjeve në raport me sigurinë ndërkombëtare nga ndikimi i terrorizmit bashkëkohor.

Në kapitullin e gjashtë trajtohet rasti studimor NATO-ja, me vështrim të gjithanshëm për qasjet mbi sigurinë e kësaj organizate pas Luftës së Ftohtë. Këtu paraqiten rezultate mbi organizimin, mënyrën e veprimit dhe të bashkëpunimit me aktorë të tjerë, si dhe strategjitë në luftën kundër terrorizmit. Në këtë kapitull argumentohet hipoteza e këtij hulumtimi për nevojën e qasjes ndërvepruese dhe multilaterale në luftën kundër terrorizmit.

Në kapitullin e shtatë paraqiten përfundimet e arritura në këtë hulumtim, literatura dhe bibliografia.

Metodat shkencore të përdorura në këtë hulumtim janë: metoda historike, analitike, përshkruese, krahasuese etj.

Metoda historike është përdorur për t'i pasqyruar qasjet për sigurinë dhe sistemet e saj në periudha të ndryshme historike, në të njëjtën kohë për ta pasqyruar zanafillën e terrorizmit. Kjo metodë na ndihmon për të kuptuar se çfarë qasjesh dhe botëkuptimesh për sigurinë kishin sistemet e kaluara të sigurisë ndërkombëtare, sa sisteme të tilla ishin, përparësitë dhe të metat e atyre sistemeve dhe në çfarë kuptimi dallojnë qasjet mbi sigurinë në periudhën pas Luftës së Ftohtë në raport me qasjet e mëhershme. Përveç kësaj, kjo metodë na ndihmon për të kuptuar veprimtarinë e terrorizmit që në zanafillën e tij, si janë trajtuar më herët kërcënimet nga ky fenomen dhe për çfarë arsyeje, fenomeni i terrorizmit në periudhën pas Luftës së Ftohtë ka implikim global dhe ndikon në qasjet mbi sigurinë ndërkombëtare.

Metoda analitike bazohet në shqyrtimin dhe analizimin e të arriturave shkencore prej studiuesve të ndryshëm lidhur me qasjet mbi sigurinë dhe ndikimin e terrorizmit mbi këto qasje.

Metoda përshkruese e përdorur në hulumtim ka për qëllim prezantimin e teorive dhe të koncepteve për sigurinë në përgjithësi, veçanërisht sigurinë ndërkombëtare, si dhe anën konceptuale të fenomenit të terrorizmit, të organizatave terroriste, tipologjive të terrorizmit etj.

Metoda krahasuese është përdorur për t'i përballur qasjet e mëhershme për sigurinë ndërkombëtare në raport me ato në periudhën pas Luftës së Ftohtë. Për realizimin e disertacionit janë shfrytëzuar një sërë burimesh si, literaturë e autorëve të ndryshëm që trajtojnë çështjet e sigurisë nga pikëpamja historike dhe politike, analizim i dokumenteve strategjike, aktivitete dhe politika qeveritare, hulumtim i vlerësimeve ndërkombëtare, si dhe analizim i raporteve nga organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare.